ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-24-4093-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Digjitalizimi i sistemit të institucioneve arsimore në shkollat e Komunës së Prizrenit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**"LOGISTICS PLUS"L.L.C.**
NUI	**600101472**
Adresa	**Rr. Rexhep Krasniqi nr.5**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**-10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Edi Bunjaku**
Adresa elektronike	**vprelvukaj@logisticsplus-ks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**13.06.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Digjitalizimi i sistemit të institucioneve arsimore në shkollat e Komunës së Prizrenit

Njoftim për Kontratë: 29.04.2024

Afati i fundit për dorëzim te ofertave: 10.06.2024

Kërkesa për rishqyrtim: 31.05.2024

Vendimi per kërkesën për rishqyrtim: 03.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesën për rishqyrtim e kemi dorëzuar me datën 31.05.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6
Neni 7
Neni 28
Neni 51.3
Neni 69.2.4
Oinionin e KRPP, daet 11.09.024
Opinionin Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (nr. 1731/23, dt.19/09/2023)
Neni 108/A

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Pretendimi jonë numer një (1) në kërkesën për rishqyrtim, date 31.05.2024:

1.Autoriteti Kontraktues, me Kërkesën 1, ku kërkohet "Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara" dhe kërkesën "Operatori Ekonomik duhet të ketë përvojë në zhvillimin dhe implementimin e të paktën 1 (një) projekti për institucionet arsimore si dhe platforma e zhvilluar të ketë aplikacion për IOS dhe Android OE duhet të dëshmoj se ka përvojë në zbatimin e së paku dy (2) sistemeve të raportimit, të paktën në një organizatë me mbi 100 përdorues." shkel paragrafin 2.1 dhe 4.2 te nenit 69, nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, përmes të cilave e redukton konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik dhe opinionin 11.09.06.2023 nga KRPP. Po ashtu vlera financiare jo me e vogël se jo më e vogël se 450.000,00 €, është ne kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik, sepse kjo kërkesë duhet te jete teke kërkesat për qarkullim, jo te vlera e referencave.

Përgjigja e Autoriteti Kontraktues ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim për pretendimin numer 1, citat:

Lidhur me pretendimin tuaj ankimor nr nje (1), eshte pjeserisht i bazuar. Bazuar ne nenin 69 aftesia teknike dhe/ose profesionale Autoriteti Kontraktues duhet te kerkoj deshmi per tre vitet e fundit ku edhe eshte kerkuar ne dosje te tenderit, ndersa sa i perket specifikimit te numrit te projekteve te implementuara kjo pjese do te riformulohet (te largohet pjesa ku ceket numri i projekteve, te vendoset teksti vetem per tre vitet e fundit) . Bazuar ne pretendimin tuaj se eshte bere shkelje e Ligjit te Prokurimit lidhur me vleren financiare 450.000.00€ te vendosur ne reference, ju beje te ditur qe vlera eshte vendosur ne

perpikmeri me LPP-ne, neni 68 gjendja ekonomike dhe financiare pika 1 ku thuhet "Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës. Në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohet të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna". Mbarim citati.

Kërkesa me formularët 54, date 03.06.2024 dhe 07.06.2024

Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 450.000,00 Euro.

Pretendimi ankimor:

Autoriteti Kontraktues, edhe pse në formularët B54 për korrigjimin e gabimeve, nuk e ka përshkruar si ka qenë kërkesa edhe si është tani, vazhdon të favorizojë një OE duke na vënë në lajthitje sikur i ka ndryshuar kërkesat fillestare. Megjithatë, përsëri ka kërkuar projektet e natyrës së kontratës. Kërkesa për projekte të natyrës së kontratës është kërkesë favorizuese dhe e redukton konkurrencën, dhe Autoriteti Kontraktues me këtë kërkesë shkel paragrafin 2.1 dhe 4.2 të nenit 69, nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, përmes të cilave e redukton konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik dhe opinionin e datës 11.09.06.2023 nga KRPP.

Tutje, arsyetimi i Autoritetit Kontraktues që vlera financiare për projekte kërkohet me nenin 69 është keqinterpretim dhe citim i pjesshëm i nenit. Sepse në paragrafin 2 të nenit 69 thuhet: "Autoriteti kontraktues do të specifikojë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje, se cilat nga referencat e sipërpërmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dhe/ose referencat e tjera kërkohen prej tij.". Ku, referencat në paragrafin 1 janë: "raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka," "evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve," "kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik," "kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur," "Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës." Pra, për vlerën financiare (qarkullimin), nuk kërkohet referencë për punët e natyrës së projektit, por kërkohet qarkullim financiar i dëshmuar me një nga provat e lartcekura.

2. Pretendimi jonë numer dy (2) në kërkesën për rishqyrtim, date 31.05.2024:

Autoriteti Kontraktues, me kërkesat: Kërkesa 5.a. pika 3 dhe 4, shkel paragrafin 3 të nenit

51 të Ligjit për Prokurim Publik, në të cilin në mënyrë rigoroze përcaktohet se: "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse." Ndërsa kërkesa ne piken 3 që Menaxheri i Projektit "Të jetë i certifikuar për Trajner të programit të trajnimit TIK, si p.sh ekspert për e-maturën" fare nuk ka të bëje me menaxhim të projekti. Ndërsa kërkesa në piken 4 që Menaxheri i Projektit të "ketë menaxhuar së paku 2 projekte në fushën e arsimit" eshte ne kundërshtim me Opinionin Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (nr. 1731/23, dt. 19/09/2023). Përveç neneve edhe opinioneve të lartcekura, Autoriteti Kontraktues me këto kërkesa shkel edhe nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, përmes të cilave e redukton konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.

Përgjigja e Autoriteti Kontraktues ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim për pretendimin numer 2, citat:

Te dhenat e kerkuara ne specifkimin teknik nuk shkelin Ligjin 51 te LPP-se, perkurndrazi jane ne perputhshmeri te plote me LPP-ne, pasi qe ne si AK kemi kerkuar te dhena relevante dhe proporcionale ne raport me lenden perkatese. Ndersa lidhur me menaxherin e projektit nder te tjerash perpos pergaditjes profesionale eshte kerkuar te jete i certifikuar " Trajner i programit te trajnimit TIK " pasi qe certifikimi për trajnim E-Mature eshte i rendesishem per sigurimin e nje platforme cilesore dhe te pershtatshme per Maturantet.Kerkesa eshte ne perputhje te plote me "Nenin 69 Aftesite teknike dhe Profesionale si dhe 70 Standardet per Sigurimin e Cilesise", duke u siguruar që menaxheri i projektit te kete njohuri të thella dhe aftesi te perparuara per te menaxhuar kete segment te platformes. Ndersa sa i perket specifikimit te numrit te projekteve te implementuara kjo pjese do te riformulohe(te largohet pjesa ku ceket numri i projekteve, te vendoset teksti vetem per tre vitet e fundit).

Kërkesa me formularët B54, date 03.06.2024 dhe 07.06.2024

Një (1) menaxher i projektit me përvojë pune në së paku dy (2) projekte që janë të ndërtuara në teknologji për web aplikacione me kompleksitete të mëdha si ne fushën e arsimit, financave apo te ngjashme;
2. Të jetë i diplomuar në shkenca kompjuterike ose inxhinieri softuerike;
3. Të jetë i certifikuar për Trajner të programit të trajnimit TIK, si p.sh ekspert për e-maturën.
4. Të ketë së paku 6 vite përvojë, dhe tdëshmoj se ka implementuar projekte të natyrës së kontratës në tri vitet e fundit projekte në fushën e arsimit.

Pretendimi ankimor:

Autoriteti Kontraktues, edhe pse në formularët B54 për korrigjimin e gabimeve, nuk e ka përshkruar si ka qenë kërkesa dhe si është tani, vazhdon të favorizojë një OE duke na vënë në lajthitje sikur i ka ndryshuar kërkesat fillestare. Megjithatë, përsëri ka kërkuar që Menaxheri i Projektit të ketë përvojë pune 6-vjeçare në projekte të natyrës së kontratës. Kërkesa që Menaxheri i Projektit të ketë përvojë pune 6-vjeçare në projekte të natyrës së kontratës është kërkesë favorizuese dhe e redukton konkurrencën. Po ashtu, insistimi i Autoritetit Kontraktues që Menaxheri i Projektit të jetë i certifikuar për trajner në e-matura

dhe arsyetimi i dhënë në vendimin e Autoritetit Kontraktues për certifikatën e-matura, përveç që është qesharak dhe i pabazuar, është edhe në kundërshtim me parimet themelore të LPP, duke e reduktuar konkurrencën pasi që një certifikim i tillë është i "shpikur" dhe nuk ekziston në institucionet arsimore apo në organizatat ndërkombëtare që merren me certifikime të TIK. Me këto kërkesa, Autoriteti Kontraktues shkel edhe nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, duke reduktuar konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.

3. Pretendimi jonë numer tre (3) në kërkesën për rishqyrtim, date 31.05.2024:

Autoriteti Kontraktues, me kërkesat: Kërkesa 5.b. për certifikimet e kërkuara, shkel paragrafin 3 të nenit 51 të Ligjit për Prokurim Publik, në të cilin në mënyrë rigoroze përcaktohet se: "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse." Ndërsa kërkesa që Menaxher teknik i projektit të jetë i certifikuar me ISO IEC 27001 Foundation si dhe të jetë i certifikuar në CCNA 1,2,3,4" fare nuk ka të bëje me menaxhim teknik dhe është në kundërshtim me Opinionin Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (nr. 1731/23, dt. 19/09/2023). Përveç neneve edhe opinioneve të lartcekura, Autoriteti Kontraktues me këto kërkesa shkel edhe nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, përmes të cilave e redukton konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.

Përgjigja e Autoriteti Kontraktues ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim për pretendimin numer 3, citat:

3. Specifikimi teknik i Menaxherit Teknik eshte ne perputhshmeri me nenin 51 te LPP-se, pasi qe detyrat e Menaxherit Teknik ne kete projekt nder te tjerash jane edhe Zgjedhja dhe implementimi i teknologjive, planifikimi dhe organizimi i te gjitha fazave te zhvillimit te platformes, implementimi dhe perdorimi i saje ne menyre efikase dhe te sigurt etj. Gjithashtu eshte ne perputhshmeri te plote me "Nenin 69 Aftesite teknike dhe Profesionale si dhe 70 Standardet per Sigurimin e Cilesise".

Kërkesa me formularët B54, date 03.06.2024 dhe 07.06.2024

Një(1) menaxher teknik të projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Shkencave Kompjuterike – minimumi tri (3) vite përvojë pune pas diplomimit dhe të jetë i certifikuar me ISO IEC 27001 Foundation si dhe të jetë i certifikuar në CCNA 1,2,3,4

Pretendimi ankimor:

Autoriteti Kontraktues, duke u munduar të arsyetojë kërkesën fillestare në vendimin e kërkesës për rishqyrtim, tregon qartë që këto certifikime nuk janë të nevojshme për Menaxherin Teknik, por janë vendosur me qëllim favorizimi dhe reduktimi të

konkurrencës, pasi që arsyetimi i dhënë nuk përkon me kërkesën tonë për rishqyrtim. Ne, në kërkesën për rishqyrtim, kemi thënë që kërkesa e Autoritetit Kontraktues që Menaxheri Teknik të jetë i certifikuar me CCNA 1,2,3,4 (katër certifikime) dhe ISO 27001, vetëm e redukton konkurrencën dhe nuk është drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën - pozitën e kërkuar pasi që CCNA 1,2,3,4 janë certifikime nga prodhuesi CISCO dhe nuk janë për Menaxher Teknik por për ekspertë që merren me implementimin e rrjeteve (Network). Po ashtu, certifikimi ISO 27001 nuk është relevant për pozitën; një certifikim ISO 27001 mund të jetë relevant për Ekspert të Sigurisë, por jo për Menaxher Teknik. Pra, këto kërkesa nuk janë relevante për pozitën dhe janë kërkesa favorizuese të cilat e reduktojnë konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës është i ndaluar me nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.

4. Pretendimi jonë numer katër (4) në kërkesën për rishqyrtim, date 31.05.2024:

Autoriteti Kontraktues, me kërkesat: Kërkesa 5c. Ekspert këshillues te projektit në inxhinieri softuerike dhe web dizajn, Kërkesa 5d. ekspert këshillues të projektit për temat financiare dhe Kërkesa 5e. Ekspert këshillues të projektit për temat juridike, shkel paragrafin 3 të nenit 51 të Ligjit për Prokurim Publik, në të cilin në mënyrë rigoroze përcaktohet se: "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse." Ndërsa këto pozita nuk janë as për së afërmi drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse, por të njëjtat janë vendosur për të favorizuar një Operator Ekonomik. Përveç shkeljes së paragrafit 3 të nenit 51 të Ligjit për Prokurim Publik, Autoriteti Kontraktues, me këto kërkesa për pozitat e lartcekura, shkel edhe nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, përmes të cilave e redukton konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.

Përgjigja e Autoriteti Kontraktues ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim për pretendimin numer 4, citat:

4. Kerkesat per ekspertet e projektit jane ne perputhshmeri ne plote me Ligjin 51 te LPP-se, pasi qe keto pozita jane relevante dhe proporcionale me raportin dhe lenden e kontrates, gjithashtu ne perputhsgmeri te plote me Nenin 69 te LPP-se Aftesite Teknike dhe Profesionale ku thuhet se " Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen".

Kërkesa me formularët B54, date 03.06.2024 dhe 07.06.2024

Një(1) menaxher teknik të projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i

Shkencave Kompjuterike – minimumi tri (3) vite përvojë pune pas diplomimit dhe të jetë i certifikuar me ISO IEC 27001 Foundation si dhe të jetë i certifikuar në CCNA 1,2,3,4

Pretendimi ankimor:

Autoriteti Kontraktues, duke u munduar të arsyetojë kërkesën fillestare në vendimin e kërkesës për rishqyrtim se kërkesa për: a) Ekspert këshillues të projektit në inxhinieri softuerike dhe web dizajn; b) Ekspert Këshilleus të projektit për temat financiare dhe c) Ekspert këshillues të projektit për terma juridike se është relevante dhe proporcionale me raportin dhe lëndën e kontratës, duke mos arsyetuar pse është relevante dhe duke u munduar të na vë në lajthitje me arsyetimin, na e bën të qartë që këto pozita janë vetëm për favorizim dhe reduktim i konkurrencës. Sepse pozitat këshilluese janë pozita këshilluese dhe Autoriteti Kontraktues, edhe pse specifikimin teknik ia ka përshtatur një Operatori Ekonomik i cili veçse e ka platformën e gatshme, nuk ka kërkuar propozim të zgjidhjes dhe këshillim për zgjidhjen, por ka kërkuar implementim të zgjidhjes sipas aneks 1 të dosjes së tenderit për pjesën e parë e cila duhet të jetë e gatshme, pra kërkesë favorizuese dhe një pjesë e dytë e cila duhet të zhvillohet-përshtatet, e cila fare nuk ka të bëj me web dizajn, financa apo çështje juridike. Pra, AK ka harruar që për zhvillim të një softueri duhet të ketë zhvillues, jo këshilltar. Që nënkupton se, AK ka vepruar kryekëput në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 51, ashtu që ka vendosur kritere që nuk janë as për së afërmi relevante me lëndën e kontratës. E njashtu, ka favorizuar OE tjetër, duke vepruar në kundërshtim me nenin 7, 28 dhe nenin 6 të LPP-së. Provë shtesë, pozitat e kërkuara ku asnjë pozitë nuk është për zhvillues të softuerit

5. Pretendimi jonë numer pesë (5) në kërkesën për rishqyrtim, date 31.05.2024:

5. Autoriteti Kontraktues, me kërkesat: Kërkesa 5.e., shkel paragrafin 3 të nenit 51 të Ligjit për Prokurim Publik, në të cilin në mënyrë rigoroze përcaktohet se: "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse." Sepse kërkesa: "Operatori ekonomik duhet të ofrojë stafin teknik të nevojshëm, minimum i 7 punëtorë për ofrimin e përkrahjes teknike përmes telefonit dhe e-mail në kohë 24 orë në 7 ditë (24 7)", as për së afërmi nuk është drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse por e njëjta është vendosur për të favorizuar një Operator Ekonomik. Përveç shkeljes së paragrafit 3 të nenit 51 të Ligjit për Prokurim Publik, Autoriteti Kontraktues, me këto kërkesa për pozitat e lartcekura, shkel edhe nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, përmes të cilave e redukton konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.

Përgjigja e Autoriteti Kontraktues ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim për pretendimin numer 5, citat:

Kjo eshte nje praktike e rendesishme per te siguruar cilesi dhe suksesin e projektit. Percaktimi i tyre ne projekt nuk eshte shkelje e ligjit te prokurimit, por eshte nje hap i rendesishem per te siguruar suksesin dhe cilesine e projektit. Keta eksperte jane te

nevojshem per te siguruar qe projekti te permbushe standardet e duhura dhe te ofroje nje pervoje mesimore te pasur dhe te pershtatshme per perdoruesit.

Kërkesa me formularët B54, date 03.06.2024 dhe 07.06.2024

Një ekspert këshillues të projektit për temat financiare.

Pretendimi ankimor:

Fakti që Autoriteti Kontraktues nuk e ka argumentuar bazën ligjore se pse duhen 7 vetë të japin përkrahje teknike 7 ditë, 24 orë në ditë (24/7), na lë të kuptojmë që pretendimi ynë në kërkesën për rishqyrtim qëndron dhe kërkesa është favorizuese dhe redukton konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.
Gjithashtu, stafin teknik e ka kërkuar vetëm për 1 vit, duke harruar që projekti do të zgjasë 3 vite, gjegjësisht 36 muaj. Megjithatë, edhe po të kishte përmendur bazën ligjore të LPP-së, kjo kërkesë bie në kundërshtim edhe me Ligjin e Punës dhe Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në punë, për shkak që asnjë person nuk mund të punoj 24/7.

6. Pretendimi jonë numer gjashtë (6) në kërkesën për rishqyrtim, date 31.05.2024:

Autoriteti Kontraktues, me kërkesat: Kërkesa 5h, shkel paragrafin 3 të nenit 51 të Ligjit për Prokurim Publik, në të cilin në mënyrë rigoroze përcaktohet se: "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse." Sepse kërkesa: "Një Ekspert për Kontrollë të Cilësisë 1.Përvojë pune në së paku dy (2) projekte që janë të ndërtuara në teknologji për web aplikacione dhe web dizajn me kompleksitete te mëdha" as për së afërmi nuk përkon me dhe nuk është relevante në raport me lëndën e kontratës, dhe është në kundërshtim me Opinionin Ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (nr. 1731/23, dt. 19/09/2023). Përveç neneve edhe opinioneve të lartcekura, Autoriteti Kontraktues me këto kërkesa shkel edhe nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, përmes të cilave e redukton konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.

Përgjigja e Autoriteti Kontraktues ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim për pretendimin numer 6, citat:

6. Vendosja e kriterit per Ekspertin per kontrolle te cilesise nuk eshte kriter diskriminues, perkundrazi angazhimi i ekspertit te tille siguron cilesine ne te gjithe procesin ne menyre qe platforma ti permbushe standardet e percaktuara duke shmangur problemet qe mund te cojne ne probleme me cilesine. Ndersa sa i perket specifikimit te numrit te projekteve te implementuara kjo pjese do te riformulohet, (te largohet pjesa ku ceket numri i projekteve, te vendoset teksti vetem per tre vitet e fundit).

Kërkesa me formularët B54, date 03.06.2024 dhe 07.06.2024

Një Ekspert për Kontrollë të Cilësisë
1. Përvojë pune në implementi m të projekteve në tri vitet e fundit
2. Të jetë i diplomuar në ndonjërën nga fushat e inxhinierisë;

Pretendimi ankimor:

Pajtohemi me korrigjimin e bërë nga Autoriteti Kontraktues për pretendimin done numer gjashtë (6).

7. Pretendimi jonë numer shtatë (7) në kërkesën për rishqyrtim, date 31.05.2024:

7. Autoriteti Kontraktues, me kërkesat: Kërkesa 6, shkel paragrafin 3 të nenit 51 të Ligjit për Prokurim Publik, në të cilin në mënyrë rigoroze përcaktohet se: "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse." Sepse kërkesa: "Operatori ekonomik duhet të posedojë hapësirë – sallë totale minimumin 200 m2, me të gjitha pajisjet e nevojshme për mbajtjen e trajnimeve të stafit për ketë modul.", as për së afërmi nuk është drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse por e njëjtat është vendosur për të favorizuar një Operator Ekonomik. Përveç shkeljes së paragrafit 3 të nenit 51 të Ligjit për Prokurim Publik, Autoriteti Kontraktues, me këto kërkesa për pozitat e lartcekura, shkel edhe nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, përmes të cilave e redukton konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.

Përgjigja e Autoriteti Kontraktues ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim për pretendimin numer 7, citat:

7. Autoriteti Kontraktues me kerkesen per posedimin e salles per mbajtjen e trajnimeve ne pronesi te OE konkurese ose me marrveshje ka vepruar ne perputhshmeri me LPP-ne.

Kërkesa me formularët B54, date 03.06.2024 dhe 07.06.2024

Operatori ekonomik duhet të posedojë hapësirë – sallë totale minimumin 200 m2, me të gjitha pajisjet e nevojshme për mbajtjen e trajnimeve të stafit për ketë modul.

Pretendimi ankimor:

Fakti që Autoriteti Kontraktues nuk e ka argumentuar bazën ligjore, na lë të kuptojmë që pretendimi ynë në kërkesën për rishqyrtim qëndron dhe kërkesa është favorizuese dhe redukton konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.

8. Pretendimi jonë numer tetë (8) në kërkesën për rishqyrtim, date 31.05.2024:

8. Autoriteti Kontraktues, me kërkesat: Kërkesa 7, shkel edhe nenin 7 dhe nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, përmes të cilave e redukton konkurrencën. Reduktimi i konkurrencës, përveç që është i ndaluar me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik. Sepse për kërkesat harduerike, ka favorizuar një prodhues te vetëm per te cilin ka kërkuar autorizim nga prodhuesi ose distributori, nuk ka vendosur sasi dhe të njëjtat nuk ekzistojnë ne tabelë te çmimeve, pra te gjitha këto janë vendosur vetëm për reduktim te konkurrencës.

Përgjigja e Autoriteti Kontraktues ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim për pretendimin numer 8, citat:

8. Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur per qellim reduktimin e konkurences lidhur me kete kriter te vendosur, kjo pjese do te riformulohet (specifikimet teknike, per pajisje te largohet teresisht, pra mos te kerkohet katalog as autorizues).

Kërkesa me formularët B54, date 03.06.2024 dhe 07.06.2024

Operatori ekonomik duhet të ketë platformën e gatshme, me kërkesat sipas Aneksi 1. Specifikimet teknike te detyrueshme, të Fazës së parë (1), në muajin e parë.
Trajnimi i zyrtarëve të IT-se së shkollave për përdorim të tyre (50 orë).
MIRËMBAJTJA Mirëmbajtja dhe ofrimi i mbështetjes teknike 24h 7 do të jetë një (1) vit pas pranimit dhe funksionalizimit të databazës.

Pretendimi ankimor:

Autoriteti Kontraktues, me formularët B54, datë 03.06.2024 dhe 07.06.2024, tregon shumë qartë, shkurt dhe hapur që pretendimi ynë në kërkesën për rishqyrtim është i saktë: Autoriteti Kontraktues ka favorizuar një Operator Ekonomik duke ia përshtatur kërkesat në Aneksin 1. Specifikimet teknike të detyrueshme përputhen me sistemin të cilin e ka të zhvilluar ky Operator Ekonomik duke vepruar ne kundërshtim te plote me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik, është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik.

Pretendimi 9, 10, 11 edhe 12:

Megjithatë, AK duke u munduar të na vë në lajthitje ne si OE, dhe ju si OSHP, është munduar të ndajë paragrafet me numra, kinse i ka shqyrtuar pretendimet tona – megjithatë, pretendimet tona në paragrafët 9, 10, 11 dhe 12 të Kërkesës sonë për Rishqyrtim të datës 31.05.2024, nuk janë shqyrtuar fare në Vendimin e AK të datës 03.06.2024. Ky veprim i AK-së vetëm sa forcon faktet që, përveç shkeljeve të dispozitave ligjore të lartpërmendura, shkelë edhe nenin 108/A të LPP-së, duke mos shqyrtuar të gjitha pretendimet tona, e duke mos i arsyetuar ato (paragrafi 12 i nenit 108/A). Andaj, si rezultat i kësaj, pretendimet tona (nr. 9, 10, 11 dhe 12) në kërkesën për

rishqyrtim, mbesin të njëjta edhe në ankesë.

Nga sa më sipër, kërkojmë nga OSHP që:
1. Të DETYROJ AK-në që të anuloj këtë procedurë të prokurimit
2. TË DETYROJ AK-në që të përpiloj një Dosje të Tenderit duke respektuar dispozitat ligjore të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale jane rreth 3,500.00 Euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*